

Qëllimi i Shërbimeve të Punësimit është të ndihmojë punëkërkuar për tu integruar në tregun e punës dhe punëdhënësit për të plotësuar vendet e lira të punës, të ofruara prej tij .

Objektivat

Objektivat e shërbimeve publike të punësimit janë :

- a) të informojnë
- b) të këshillojnë
- c) të orientojnë
- d) të ndërmjetësojnë punëkërkuar të papunë për vendet e lira të punës të ofruara nga punëdhënësit .

Klientët

Shërbimet Publike të Punësimit mbështesin në mënyrë të balancuar dy grupe të mëdha klientësh brenda tregut të punës; punëkërkuar dhe punëdhënësit.

Shërbimet publike të punësimit në zbatim të kuadrit ligjor përfshijnë :

- 1- Informacion për vendet e lira të punës
- 2- Ndërmjetësim për punësim
- 3- Këshillim dhe orientim për punë dhe profesion

a. Për Punëkërkuar shërbimet ofrojnë si më poshtë

- Informacion dhe këshillim
- Udhëzime për punësim, vlerësim të nevojave, zhvillim të karrierës/profesionit/Plan Aksioni për Punësim.
- Pjesëmarrje në një trainim dhe ndërhyrje të tjera në tregun e punës.
- Shërbime të tjera ndërmjetësimi.

b. Për Punëdhënësit shërbimet ofrojnë si më poshtë

- Shërbime profesionale rekrutimi
- Paraqitje dhe përshkrim të kandidatëve
- Mbështetje për punësim (Programe të Nxitjes së Punësimit)
- Kontakte në vazhdim

Ndërmjetësim

përputhja e ofertës për një vend të lirë pune me kërkesën e një kandidati të përshtatshëm për punë.

Punëkërkuar

Punëkërkuar i Papunë është një person, i cili :

- a) jeton në Shqipëri,
- b) është mbi 16 vjeç
- c) paraqitet personalisht në Zyrën e Punësimit dhe është i disponueshëm për punësim
- d) është i aftë për punë

Punëkërkuar i punësuar është një person i cili :

- a) është në marrëdhënie pune ose i vetëpunësuar, por që kërkon një punë të re